

## RELACION

### Mbi Ecurine Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 3-mujorin e dytë të vitit 2012

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të Ligjit nr. Nr. 10 487, dhe datë 5.12.2011 "Per buxhetin e shtetit për vitin 2012", Udhezimit nr. 2 datë 6.02.2012 "Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetin"

dhe Udhezimit nr.2/1 datë 15.02.2012 "Per zbatimin e buxhetin e shtetit për vitin 2012", i është akorduar një fond i planifikuar prej **94 milione e 852 mijë lekë**, i cili përbehet nga:

Fondi i Pagave:	11,089,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	1,703,000 Leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	4,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	76,000,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individet:	60,000 Lekë (zeri 606) Fondi
per Investimet e Trupezuara:	2,000,000 Lekë (zeri 231)

Nga fondi i pergjithshem buxhetor, per periudhen e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në 80,302,344 leke nga totali prej 94.852.000 Leke ose **84.6%**, të fondit të planifikuar vjetor.

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore** (zeri 600-601), është realizuar në zbatim te strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 "PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE".

Nga fondi i pergjithshem i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, per këtë periudhë, është realizuar respektivisht; **4,791,939 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi **43.2%**. **812, 791 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **16.7%**.

**Fondi per shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime** (zeri 602), per vitin 2012, në fillim ishte planifikuar ne vlerën 7,000,000 leke, por duke pare nevojen e Institucionit per fonde per OJF, i cili eshte dhe misioni kryesor i AMSHC, ky ze u reduktua me 3,000,000 lekë, pra

vlera e re e ketij zeri eshte 4,000,000 lekë. Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **2,335,014 Lekë** ose **58.3%** e planit vjetor. Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me; -Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike falas për publikun, në funksion të një veprimtarie normale institucionale. -Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevojat e AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj. -Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitore dhe të treta, të mbartura nga 2011.

**Fondi në zerin për Transferime Korrente të Brendshme** (zeri 604), për vitin 2012 ishte planifikuar në vlerën 73,000,000 leke por u shtuan në 76,000,000 leke. Ky është dhe zeri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC, duke qenë se dhe vetë misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grantë për projektpropozimet të OJF përfituese. Edhe për këtë zë, për periudhen respektive është realizuar vlera prej **71, 778, 400 Lekë** ose **94.4%**, e planit vjetor. Në realizimin e këtij zeri, AMSHC ka vazhduar me disbursimet për kështin e parë dhe të dytë (50% dhe 40%) e thirrjes së tretë dhe me kështet e mbetura të Grantëve të miratuara dhe të kontraktuara të thirrjeve të mëparshme për OJF.

**Fondi për shpenzim investime** (zeri 231) ,

**2,000,000 Lekë** (zeri 231) për Investime të Trupezuara. Për periudhen respektive është realizuar vlera prej **584,200 Lekë** ose **29.2%**, e planit vjetor.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Datë 09.03.2009 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Agjencisë për Mbeshtetjen e Shoqërisë Civile", si dhe legjislacionin administrativ-financiar shqiptar.

**Drejtor Ekzekutiv**

**RUDI BOBRATI**